

VENDIM
Nr. 418, datë 8.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 953, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, ‘PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 10, “Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së”, në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së

1. Në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit, kërkesat për rimbursimin e TVSH-së të bëra nga personat e tatueshëm eksportues dhe personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor, ndahen sipas kategorive të parashikuara në këtë nen.

2. Rimbursohen automatikisht, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes, kërkesat për rimbursim të TVSH-së, të vlerësuara si kërkesa të bëra nga personat e tatueshëm të përmendur në pikën 1, të këtij neni, me risk zero, të cilët plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

- a) kanë status të aktivitetit “aktiv”;
- b) vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70 (shtatëdhjetë) % e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, e verifikuar edhe nga raportet doganore të eksporteve në sistem;
- c) kanë aktivitet eksportues mbi 1 (një) vit;
- ç) nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

3. Kërkesat e personave të tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50 (pesëdhjetë) % deri në 70 (shtatëdhjetë) % të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtuar më parë procedurës së analizës së riskut. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe kërkesat e personave të tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve është mbi 70 (shtatëdhjetë) %, por që nuk plotësojnë njëkohësisht kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.

Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t’i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, me përjashtim të kërkesave të personave të tatueshëm që rezultojnë me status të aktivitetit “pasiv”, të cilët detyrimisht do të rimbursohen pas përfundimit të procedurës së kontrollit tatimor.

4. Të gjithë personat e tjerë të tatueshëm që kryejnë eksporte, por që nuk klasifikohen në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, rimbursohen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, duke iu nënshtuar procedurës së analizës së riskut.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe